



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 311 Prot.

Vlorë më, 06.01. 2022

**VENDIM**  
Nr. 1, datë 05.01.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 42, DATË 15.11.2021 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË"**

Mbështetur në nenin 38, pika 1, shkronja d në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 19, pika 1, shkronja dh në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM-në nr. 808, datë 11.12.2019 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'profesor i asociuar' dhe 'profesor'", Senati Akademik, në mbledhjen e datës 05.01.2022

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 42, datë 15.11.2021 të Senatit Akademik bëhen këto ndryshime:

a. Neni 12, pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

- a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor";
- b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor i asociuar";
- c) shkronja "c" hiqet.

b. Neni 10, pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

3. Tarifa e studimit dhe rregullat për afatet e pagesës për të gjithë kohëzgjatjen e programit përcaktohen me vendime të posaçme të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

2. Ndryshimet pasqyrohet në tekstin e rregullores si këtu bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. As. Xhiliola AGARAJ (SHËHU)**

